



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 671/prot.
1

Tiranë më 26.4.2019

Lënda: Mendim mbi *“Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin e Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi bashkëpunimin për përdorimin e informatave për pasagjerët”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr.16/8 prot., datë 01.04.2019, protokolluar me tonën nr.671prot., datë 26.04.2019, mbi Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin e Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi bashkëpunimin për përdorimin e informatave për pasagjerët, Zyra e Komisionerit vlerëson se i gjithë procesi për transferimin e të dhënave të informacionit mbi pasagjerët, duhet të kryhet në respektim të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në aktet ndërkombëtare si dhe ato të sanksionuara në legjislacionin vendas.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 27 Prill 2016 *“Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”* (GDPR), por edhe në kuadër të procesit të integritetit të vendit, sjellim në vëmendje marrjen në konsideratë të parashikimeve të kësaj Rregulloreje.

Sa më sipër, në nenin 3 të Rregullores, parashikohet se fusha e zbatimit territorial të saj, i shtrin efektet edhe në vendet jashtë Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, duke qenë se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të transferohen edhe të dhëna të shtetasve (*pasagjerë*) të Bashkimit Evropian, pala shqiptare duhet të garantojë që e gjithë procedura e mëtejshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje të realizohet në përputhje me dispozitat e Rregullores së BE-së. Efektet ligjore dhe sanksionet e parashikuara në këtë akt aplikohen edhe për vendet e treta, në rastin konkret edhe për Shqipërinë.

Gjithashtu, referuar nenit 4, të marrëveshjes së bashkëpunimit, vlerësojmë të rëndësishme parashikimin e detajuar mbi gjithë procedurat e përpunimit, aksesimit, transferimit, masave të sigurisë së të dhënave personale, parimit të mjaftueshmërisë, afatin e ruajtjes së të dhënave dhe garantimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, si parime kryesore të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

